

MBI
AUDITIMIN E USHTRUAR NË
BASHKINË LAÇ

Raporti Përfundimtar i Auditimit të kryer në **Bashkinë Laç**, me objekt: “Mbi vlerësimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, aktivitetit ekonomik e financiar, prokurimet me fondet publike, taksat dhe tarifat vendore, procedurat e shqyrtimit dhe miratimit të studimeve urbanistike, shesheve e lejeve të ndërtimit, lejeve të shfrytëzimit, administrimin e aseteve, dhënien me qira të objekteve pronë publike, funksionimi i policisë bashkiake”, lloji i auditimit: “Për auditimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë financiare”, për periudhën e veprimtarisë 01.01.2012 deri 31.12.2013 dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 33, datë 31.03.2014.

Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 “Për Kontrollin e Lartë të Shtetit”, me ndryshimet e bëra me ligjin nr. 8599, date 01.6.2000, Kontrolli i Lartë i Shtetit me shkresën nr. 1077/7, datë 31.3.2014, i ka rekomanduar z. Artur Bardhi Kryetar i Bashkisë, zbatimin e masave të mëposhtme:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Të merren masa për zbatimin e të gjitha rekomandimeve të dërguara nga KLSH-ja me shkresën nr. Prot. 324/6, datë 27.01.2012, të pazbatuara deri në momentin e këtij auditimi.

Menjëherë

2. Të merren masa në lidhje me zbatimin e procedurave në ngritjen e funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 6296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” si dhe shkresën e Ministrisë së Financave nr. 6082, datë 16.03.2011 “Mbi hapat që duhen ndjekur nga njësitë publike mbi implementimin e këtij ligji”.

Menjëherë

3. Për çdo procedurë prokurimi që do të zhvillohet në të ardhmen, nga ana e titullarit të Autoritetit kontraktor ose personit të autorizuar prej tij, të sigurohet një ndarje e qartë e detyrave ndërmjet punonjësve të përfshirë në hartimin e dokumenteve të tenderit dhe atyre të përfshirë në procesin e vlerësimit dhe të përzgjedhjes së fituesit, sipas shkronjës “a”, pika 1, të kreut V-të, të VKM nr 1, datë 10.01.2007, të ndryshuar.

Vazhdimisht

4. Dokumentet e tenderit të plotësohen me të gjithë dokumentacion e nevojshëm me qëllim llogaritjen sa më të saktë të vlerës së kontratës dhe argumentimin e fondit limit, me specifikime teknike të sakta, duke bërë sqarimet e nevojshme me shkrim në rastin e përdorimit të punës së specialistëve nga jashtë institucionit. Preventivat të hartohen sipas manualeve të miratuara me vendime të Këshillit të Ministrave dhe të paraqiten analizat e këtyre çmimeve, sipas VKM nr. 1, datë 10.01.2006, i ndryshuar, Kreu II, pika 2/a, c, ç.

Vazhdimisht

5. Në prokurimet e punëve publike, ofertat e paraqitura nga operatorët ekonomikë të pranohen vetëm kur janë të shoqëruara me analizat tekniko-financiare të punimeve, sipas kërkesave të

Dokumenteve Standarte të Tenderit (DST), Kap. 3 “Udhëzime për operatorët ekonomikë”, paragrafi 3.12, “Llogaritja e çmimit”.

Vazhdimisht

6. Për prokurimet që do të kryhen në të ardhmen, të mos veprohet me opsionin se “nuk argumentohen “ekonomikisht” një pjesë e zërave të preventivit”, *(siç është vepruar në procedurën e prokurimit me objekt: “Rikonstrukcion i Shkollës 9-vjeçare nr. 1”, ku është skualifikuar operatori ekonomik “E...M...” shpk., edhe pse oferta e tij ka qenë më e ulët krahasuar me operatorin ekonomik fitues).*

Vazhdimisht

7. Nga autoriteti i planifikimit Bashkia Laç të mos miratohet asnjë leje zhvillimi në mungesë të planifikimit vendor të miratuar nga Këshilli Kombëtar i Territorit (KKT) dhe deri në momentin e miratimit të planit vendor, t'i kthehet përgjigje mohuese brenda afateve të caktuara në ligj, të gjithë kërkesave për leje zhvillimi dhe leje ndërtimi.

Vazhdimisht

8. Për **11 pasuri** “Troje dhe Rrugë të Brendshme”, me nr. pasurie 1/95/2, 3/7/1, 4/567, 4/287, 1/199/1, 3/15, 1/180, 8/108, dhe pasuritë pa numër nr. rendor 19, 20, 21,(3 troje të ish-fabrikës së kuarcit), të kërkohet konfirmimi për këto pasuri nga ZVRPP Laç dhe t'i dërgohet shkresë Ministrisë së Brendshme (Agjencisë së Inventarizimit dhe Transferimit të Pronave Publike), për kalim në inventarin e Bashkisë Laç, të cilët nuk përfshihen në shkresat nr. 430, datë 07.03.2014 dhe nr. 475, datë 18.03.2014.

Menjëherë

9. Titullari i Bashkisë të ngrejë komisionin për marrjen në dorëzim të aseteve, si dhe të kryhet marrja në dorëzim, kolaudimi, të kryhet inventarizimi kontabël dhe fizik, të aplikohet në ZVRPP Laç për regjistrim në përputhje me aktet për llojin e disponimit të tyre dhe pas regjistrimit të kryhet evidentimi në kontabilitet, i aseteve, resurseve dhe pasurive të tjera, sipas ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” dhe pikat 37, 42-60, 74, të Udhëzimit të Ministrisë Financave nr. 30, datë 27.12.2011 ”Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”.

Deri më 30.06.2014

10. Bashkia Laç t'u drejtohet organeve kompetente të zbatimit të ligjit, për lirimin e menjëhershëm të 38 pasurive të Bashkisë të cilat sipas inventarit përfundimtar rezultojnë të “zëna forcërisht” ose të “tjetërsura”, *pasuri të cilat nuk posedohen nga kjo Bashki për sipërfaqen e përgjithshme të truallit prej 21970 m² dhe sipërfaqe ndërtimi (njolla) 2157 m²; të evidentohen dhe identifikohen hollësisht të gjitha pasuritë e tjera që rezultojnë të “zëna forcërisht” në mënyrë të paligjshme dhe të rikërkojë lirimin e tyre nga organet kompetente.*

Deri më 30.06.2014

11. Nga ana e Bashkisë Laç, të vihen në eficiencë pasuritë dhe objektet të cilat rezultojnë të pazëna, të patjetërsura dhe në gjendje të mirë teknike dhe funksionale si edhe sheshet e trojet e lira dhe gjithcka tjetër e mundshme për t'u përdorur, duke lidhur kontrata qeraje për këto prona ose me mënyra të tjera menaxhimi, duke përmirësuar efikasitetin, ekonomikitetin dhe efektivitetin e përdorimit të aseteve, me qëllim rritjen e të ardhurave të Bashkisë, shtimin e investimeve dhe përmirësimin e jetesës së komunitetit.

Deri më 31.12.2014

12. Bashkia Laç, për pasuritë të cilat rezultojnë pa sipërfaqe trualli dhe ndërtimi në inventarin e pronave të Bashkisë Laç, të cilat nuk mund të administrohen dhe as të vlerësohen, të kryejë identifikimin e tyre duke përcaktuar sipërfaqet si elemente të domosdoshme për regjistrimin në ZVRPP dhe në bilancin e Bashkisë Laç.

Deri më 30.06.2014

13. Për objektin “Pallati i Kulturës Laç+Bodrumi” me sipërfaqe 336 m², i cili prej 5 vjetësh vazhdon të posedohet, gëzohet dhe disponohet nga një person fizik, nga Bashkia Laç të kërkohet arkëtimi i të gjithë qirave të pallogaritura dhe të papaguara gjë e cila vetëm për periudhën 01.07.2011-31.12.2013 rezulton si e ardhur e munguar 2,436,336 lekë dhe më pas të kërkohet rinovimi i kontratës së qirasë, në të kundërt Bashkia t`u drejtohet organeve kompetente të zbatimit të ligjit, për lirim të objektit.

Deri më 30.08.2014

14. Nga Bashkia Laç nëpërmjet Zyrës së Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës, të evidentohen saktësisht me të gjitha dimensionet dhe cilësitë, tokat bujqësore “të zëna forcërisht”, të kryhet lirimi i tyre nëpërmjet organeve kompetente dhe të përgatitet dokumentacioni; të kryhet reklamimi i nevojshëm për shfrytëzimin e tyre sipas mënyrave që ka përcaktuar ligjvënësi në dobi të interesit publik (pas përfundimit të pezullimit).

Deri më 30.06.2014

15. Të detajohen elektronikisht detyrimet debitore për çdo subjekt e të fillojnë procedurat ligjore për arkëtimin e tyre.

Menjëherë

16. Njoftim vlerësimet për detyrimet fiskale vendore të plotësohen e t`ju dërgohen subjekteve në afat me fillimin e vitit ushtrimor. Ndryshimet e mundshme në nivelin e detyrimeve fiskale të bëhen sipas Ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë", me ndryshimet, si dhe udhëzimit në zbatim të tij.

Brenda muajit Dhjetor të vitit ushtrimor

17. Në rregjistrin e tatimpaguesve, çdo fillim viti, të pasqyrohen të gjitha llojet e detyrimeve për secilin prej tyre e këto të bëhen të disponueshme për inspektorët e terrenit.

Vazhdimisht

18. Të bëhet ndarja me zona për inspektorët tatimorë në terren, të cilët të evidentojnë subjektet në to dhe të raportojnë në mënyrë periodike për nivelin e arkëtimeve dhe të tjera probleme që konstatojnë gjatë gjithë periudhës ushtrimore.

Vazhdimisht

19. Të ndiqen procedurat ligjore për të rivendosur në afatet e vlefshmërisë ligjore kontratën e dhënies me qira të objektit në administrimin e Bashkisë Laç për Çerdhe fëmijësh me sipërfaqe 67 m².

Brenda muajit Maj 2014

20. Të realizohen dhe dokumentohen marrëdhëniet me agjentët tatimorë si ZVRPP-në, DSHMT Rrugor për detyrimet fiskale që këto i ngarkon ligji të arkëtojnë dhe xhirojnë, brenda afateve ligjore, në favor të Bashkisë Laç.

Brenda muajit Maj 2014

21. Të dokumentohen sipërfaqet e objekteve në të cilat kryejnë aktivitet subjektet objekt i taksave dhe tarifave vendore dhe të saktësohen detyrimet fiskale nga administrimi i tyre.

Brenda muajit Maj 2014

22. Të evidentohen tabelat-reklama dhe lloji i funksionit të tyre, të dokumentohen për çdo subjekt që i administron e të bëhet vlerësimi tatimor sipas sipërfaqeve dhe destinacionit të tyre.

Brenda muajit Maj 2014

23. Të saktësohet e dokumentohet në një rregjistër (edhe elektronik), numri i familjeve, ndarë në strukturë qytet-fshat, sipas vendimeve të Këshillit Bashkiak, që janë objekt i pagesës së tarifave vendore të miratura nga ky këshill e të arkëtohen detyrimet e tyre.

Brenda muajit Maj 2014

24. Të pajisen me blloqe për aktverifikime, aktkonstatime, gjoba etj, (të gjitha të inventarizuara e me nr.serie) punojësit e Sektorit të TTV në Bashkinë Laç.

Brenda muajit Maj 2014

25. Të inventarizohet dokumentacioni në dosjet e të gjitha subjekteve e të plotësohet rigorozisht sipas dispozitave ligjore.

Brenda muajit Prill 2014

26. Të dokumentohet bashkëpunimi në fushën e realizimit të të ardhurave me Policinë Bashkiake.

Vazhdimisht

27. Të ndiqen e dokumentohen të gjithë hapat ligjor për realizimin e prishjes së objekteve që janë evidentuar për prishje në mënyrë që të shmanget maksimalisht formaliteti në vendimmarrjet për këtë qëllim.

Vazhdimisht

28. Në të gjithë dokumentacionin që plotëson INUV-i, evidentimi i personave përgjegjës për shkeljet e konstatuara të bëhet jo vetëm me emër e mbiemër, por edhe me numrin e kartës së identitetit, apo tjetër dokumente të njehsuar me të, për t'i dhënë saktësi dokumentit në përmbajtjen juridike të tij. Për të njëjtën arsye personat fizikë dhe juridik të evidentohen edhe sipas NIUS (numrit identifikues unik i subjektit). Për këtë të bëhen ndryshimet në dokumentat standarte si Akt-kontroll, Proces verbal, Vendim prishje.

Vazhdimisht

29. Të përsëriten kontratat e punës që janë pa afat dhe të ribëhen për periudhë 3-vjeçare, në respektim të dispozitave ligjore për këtë qëllim.

Brenda muajit Maj 2014

30. Nga Policia Bashkiake, të dokumentohet puna e bërë në mënyrë shkresore të protokolluar apo me dokumentacion format të miratuar, si Procesverbal, Aktkonstatimi apo Aktkontrolli etj. Këto dokumente (Proces Verbal, Akt-Konstatimi apo Akt-Kontrollit etj.) të jenë inventarial, hyrje, dalje dhe arkivim të kopjeve pas përdorimit, me numër serial, të hartuara në të paktën dy

kopje, me përgjegjësi individuale të posedimit dhe përdorimit të tyre nga secili punonjës i Policisë Bashkiake.

Vazhdimisht

31. Policia Bashkiake të bashkëpunojë me Sektorin e Financës për arkëtimin e gjobave të papaguara në shumën 7,500 lekë që i përkasin 5 rasteve.

Deri më 30.05.2014

B. MASA SHPERBLIM DËMI

Të kontabilizohet dhe të kërkohet në rrugë ligjore arkëtimi i vlerës **1,454,522 lekë** duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjyqimit, si më poshtë:

1. Për vlerën 197,000 lekë, në ngarkim të operatorit ekonomik “G...C...” shpk, për likuidim më tepër sesa vlera e kontratës së lidhur ndërmjet Autoritetit Kontraktor, Bashkia Laç me këtë operator ekonomik si fitues i tenderit të karburantit për vitin 2012.

Deri më 30.06.2014

2. Për vlerën 131,810 lekë, në ngarkim të punonjësve përfitues për organizim drekë zyrtare dhe për udhëtimin turistik në Kosovë nga punonjësit e administratës së bashkisë, si edhe për festën e Ditës së Verës, veprim ky në kundërshtim me VKM nr.243, datë 15.05.1995, “Për shpenzime për pritje e përcjellje dhe trajtim që u bëhet delegacioneve të huaja”, i ndryshuar.

Deri më 30.06.2014

3. Për vlerën 207,061 lekë, në ngarkim të 2 punonjësve nga e cila: -Vlera 118,988 lekë në ngarkim të punonjësës Xh.H. me detyrë Specialiste e Gjendjes Civile; -Vlera 88,073 lekë në ngarkim të punonjësës D.K. me Detyrë Specialiste në Sektorin e të Ardhurave, për paga të dhëna në kundërshtim me VKM nr. 545, datë 11.08.2011, i ndryshuar dhe VKM nr. 553, datë 11.08.2011, i ndryshuar.

Deri më 30.06.2014

4. Për vlerën 195, 124 lekë, në ngarkim të 5 ish punonjësve nga e cila: -Vlera 69,900 lekë në ngarkim të ish punonjësit Gj.K.; -Vlera 40,500 lekë në ngarkim të ish punonjësit V.R.; -Vlera 33,600 lekë në ngarkim të ish punonjësit D.Z.; -Vlera prej 10,000 lekë në ngarkim të ish punonjësës T.H.; -Vlera prej 47,124 lekë në ngarkim të ish punonjësës M.N. për mosndalesë të tatimit mbi të ardhurat për pagat e fituara me Vendime të Formës së Prerë të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin, “Për zgjidhje të mënjëhershme dhe të pajustificuar të kontratës së punës” nga punëdhënësi Bashkia Laç.

Deri më 30.06.2014

5. Për vlerën 36,200 lekë, në ngarkim të sektorit juridik që ka përgatitur kontratën për procedurën e prokurimit “Blerje karburanti” për vitin 2012, ku kontrata me operatorin ekonomik është lidhur me çmimin 905,000 lekë dhe fondi limit me TVSH ishte llogaritur 868,800 lekë.

Deri më 30.05.2014

6. Për vlerën 687,327 lekë, në ngarkim të 11 subjekteve, për detyrime të papaguara për vitin 2012 dhe 2013, sipas aneksit nr.1 që është pjesë përbërëse e këtij Raporti.

Deri më 30.06.2014

C. MASA DISIPLINORE

Mbështetur në nenin 37 dhe 144, të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, kërkojmë të fillojmë procedurat për dhënien e masës disiplinore:

I. “Vërejtje”, neni 9.1, shkronja “a” e Kontratës Individuale të Punës

1. Për Znj. D.K., me detyrë specialiste të ardhurash në cilësinë e anëtares së Komisionit të Prokurimit me Vlerë të Vogël për periudhën 12.08.2011 deri më 15.04.2013, në 15 raste në vlerë 1,268,306 lekë, për prokurime të kryera për blerje mallrash dhe kryerje shërbimesh, ka vepruar në kundërshtim me kërkesat ë shkronjës “c”, pika 2, Kreu VI, i VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, si dhe të pikës 5, të udhëzimit nr. 2, datë 18.02.2008 të APP-së, “Për procedurën e prokurimit me vlerë të vogël”.

2. Për Znj. M.C., me detyrë specialiste e arsimit, në cilësinë e anëtares së Komisionit të Prokurimit me Vlerë të Vogël për periudhën 12.08.2011 deri më 31.12.2011, në 8 raste me vlerë 329,056 lekë, për prokurime të kryera për blerje mallrash dhe kryerje shërbimesh, ka vepruar në kundërshtim me kërkesat ë shkronjës “c”, pika 2, Kreu VI, i VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, si dhe të pikës 5, të udhëzimit nr. 2, datë 18.02.2008 të APP-së, “Për procedurën e prokurimit me vlerë të vogël”.

3. Për Z. K.Gj., me detyrë specialist i urbanistikës, në cilësinë e anëtarit të Komisionit të Prokurimit me Vlerë të Vogël, për periudhën 12.08.2011 deri më 31.12.2013, në 15 raste me vlerë 1,268,306 lekë, për prokurime të kryera për blerje mallrash dhe kryerje shërbimesh, ka vepruar në kundërshtim me kërkesat ë shkronjës “c”, pika 2, Kreu VI, i VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, si dhe të pikës 5, të udhëzimit nr. 2, datë 18.02.2008 të APP-së, “Për procedurën e prokurimit me vlerë të vogël”.

4. Për Z. G.M., me detyrë specialist i mjedisit, në cilësinë e anëtarit të Komisionit të Prokurimit me Vlerë të Vogël, për periudhën 12.08.2011 deri më 31.12.2011, në 8 raste me vlerë 329,056 lekë, për prokurime të kryera për blerje mallrash dhe kryerje shërbimesh, ka vepruar në kundërshtim me kërkesat ë shkronjës “c”, pika 2, Kreu VI, i VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, si dhe të pikës 5, të udhëzimit nr. 2, datë 18.02.2008 të APP-së, “Për procedurën e prokurimit me vlerë të vogël”.

5. Për Z. LI.N., me detyrë përgjegjës i sektorit të shërbimeve, në cilësinë e Kryetarit të Komisionit të Prokurimit me Vlerë të Vogël, për periudhën 01.01.2012 deri më 31.12.2012, në 6 raste me vlerë 452,330 lekë, për prokurime të kryera për blerje mallrash dhe kryerje shërbimesh, ka vepruar në kundërshtim me kërkesat ë shkronjës “c”, pika 2, Kreu VI, i VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, si dhe të pikës 5, të udhëzimit nr. 2, datë 18.02.2008 të APP-së, “Për procedurën e prokurimit me vlerë të vogël”.

6. Për Znj. P.T., me detyrë ish-specialiste e financës, në cilësinë e anëtares të Komisionit të Prokurimit me Vlerë të Vogël, për periudhën 01.01.2012 deri më 31.12.2012, në 6 raste me vlerë 452,330 lekë, për prokurime të kryera për blerje mallrash dhe kryerje shërbimesh, ka vepruar në kundërshtim me kërkesat ë shkronjës “c”, pika 2, Kreu VI, i VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, si dhe të pikës 5, të udhëzimit nr. 2, datë 18.02.2008 të APP-së, “Për procedurën e prokurimit me vlerë të vogël”.

7. Për Znj. M.P., me detyrë Sekretare e Kryetarit, në cilësinë e anëtares të Komisionit të Prokurimit me Vlerë të Vogël, për periudhën 01.01.2012 deri më 31.12.2013, në 8 raste me

vlerë 939,800 lekë, për prokurime të kryera për blerje mallrash dhe kryerje shërbimesh, ka vepruar në kundërshtim me kërkesat e shkronjës “c”, pika 2, Kreu VI, i VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, si dhe të pikës 5, të udhëzimit nr. 2, datë 18.02.2008 të APP-së, “Për procedurën e prokurimit me vlerë të vogël”.

8. Për Znj. M.S., me detyrë specialiste, në cilësinë e anëtares të Komisionit të Prokurimit me Vlerë të Vogël, për peri udhën 01.01.2013 deri më 31.12.2013, në 2 raste me vlerë 487,470 lekë, për prokurime të kryera për blerje mallrash dhe kryerje shërbimesh, ka vepruar në kundërshtim me kërkesat e shkronjës “c”, pika 2, Kreu VI, i VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, si dhe të pikës 5, të udhëzimit nr. 2, datë 18.02.2008 të APP-së, “Për procedurën e prokurimit me vlerë të vogël”.

9. Për Znj. L.P., me detyrë specialiste inxhinierë, në cilësinë e anëtares së Njësisë së Prokurimit, për prokurimin e kryer në vitin 2012, me objekt “Lyerjet e shkollave dhe kopshteve”, sepse nuk u gjend dokumentacion për të vërtetuar kryerjen e analizave të kostove të punëve që do të prokurohen, pra ka mosargumentim të fondit limit, mosveprim në kundërshtim me nenin 28, të ligjit nr. 9743, 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe me VKM nr. 1, datë 10.01.2006, i ndryshuar, Kreu II, pika 2/c, ç.

II. “Vërejtje me paralajmërim për zgjidhje të kontratës së punës”, neni 9.1, shkronja “b”, e Kontratës Individuale të Punës

1. Për Znj. E.P., me detyrë specialiste në sektorin e financës, sepse:

-Në kundërshtim me lidhjen nr. 6 “Vlera e pagës së grupit të diplomave të arësimit universitar”, të VKM nr. 553, datë 11.08.2011, ndryshuar me VKM nr. 518, datë 16.08.2012, si dhe të lidhjes 2 të VKM nr. 545, datë 11.08.2011, ndryshuar me VKM nr. 524, datë 16.08.2012 dhe VKM nr. 599, datë 17.07.2013, ka paguar në mënyrë të kundërligjshme 2 punonjës me një efekt financiar në dëm të buxhetit të shtetit për vlerën 207,508 lekë.

-Në kundërshtim me ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, në 5 raste nuk ka ndaluar tatimin mbi pagë me një efekt financiar në dëm të buxhetit për vlerën 195,124 lekë.

2. Për Z. A.B., me detyrë ish-Përgjegjës i Zyrës së taksave dhe Tarifave Vendore, për periudhën 01.08.2011 deri më 01.09.2013, sepse:

-Ka vepruar në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave lokale”, i ndryshuar, ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në drejtim të programimit dhe sidomos të realizimit të tyre kundrejt programimit i cili paraqitet në nivele mjaft të ulëta.

-Për mungesë likuidimi të detyrimeve për taksat e tarifave vendore për vitin 2012 e 2013, nga 11 subjekte fizike me një efekt financiar në dëm të buxhetit të bashkisë për vlerën 687,327 lekë.

3. Për Z. B.Gj., me detyrë ish-Përgjegjës i Zyrës së Urbanistikës, për periudhën 01.08.2011 deri më 01.09.2013, sepse:

-Për periudhën 01.08.2011 deri më 01.09.2013 janë dhënë 13 leje sheshi dhe leje ndërtimi, në kundërshtim me ligjin nr. 8405, datë 17.09.1998 “Për urbanistikën”, i ndryshuar dhe me VKM nr. 722, datë 19.11.1998 “Për miratimin e rregullores së urbanistikës.

-Në cilësinë e anëtarit të KVO-së në prokurimin me objekt: “Rikonstruksion i Shkollës 9-vjeçare nr. 1”, prokurim ky i zhvilluar në 6-mujorin e II të vitit 2011, ka vepruar në kundërshtim me kërkesat e ligjit 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe VKM nr. 01, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”.

III. "Zgjidhje e kontratës së punës", neni 9.1, shkronja "d", e Kontratës Individuale të Punës.

1. Për Z. V.G., me detyrë Përgjegjës i Zyrës së Urbanistikës, për periudhën 2012-2013, si dhe në cilësinë e anëtarit të KRRT-së në mbledhjet e datave 18.08.2011 dhe 30.09.2011, sepse:

-Për periudhën 01.08.2011 deri më 01.09.2013 janë dhënë 13 leje sheshi dhe leje ndërtimi, në kundërshtim me ligjin nr. 8405, datë 17.09.1998 "Për urbanistikën", i ndryshuar dhe me VKM nr. 722, datë 19.11.1998 "Për miratimin e rregullores së urbanistikës.

-Për vitet periudhën 01.07.2011 – 31.12.2013, nga Seksioni i Urbanistikës Bashkia Laç, ishin dhënë 22 leje përdorimi objekti, për të cilat u konstatuan mangësi në plotësimin e dokumentacionit, si fotografi të objektit, procesverbale të punimeve të maskuara, relacioni gjeologjik, aktkolaudimet nga Nd UK ShA që vërtetojnë furnizimin me ujë (postim rrjeti), procesverbalet nga CEZ, që vërtetojnë marrjen në dorëzim nga filiali elektrik, deklarata e pastërtisë nga Inspektoriati i Mjedisit, vërtetim nga DPT, për faktin që subjekti ndërtues ka shlyer detyrimet.

-Për dhënie leje "Leje zhvillimi + leje ndërtimi" për objektin "Godinë Polifunkionale, 2 kate tregtare + 6 kate banimi + 1 kat nëntokësor", Lagje nr. 3, Laç, dhënë sipas vendimit të Gjykatës së Rrethit nr. 730-501, datë 16.08.2013, sipas kërkesës së bërë nga firma ndërtuese "P..." shpk me pronar truall Gj.N.

Ky vendim është marrë bazuar në vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin nr. 730-501, datë 16.08.2013, sipas padisë së Firmës "P..." shpk. Vendimarrja e saj, është bazuar në faktin e pranimit në heshtje të kërkesës së bërë nga firma drejtuar Bashkisë Laç, sepse kjo bashki nuk ka kthyer përgjigje për kërkesat e aplikuesit, sipas ligjit nr. 10119, datë 23.04.2009, të ndryshuar. Mosveprimi në këtë rast nga Bashkia Laç ka sjellë pasojë të jepet një leje zhvillimi në kundërshtim me ligjin nr. 10119, datë 23.04.2009, të ndryshuar, dhe për pasojë kryerjen e një ndërtimi të pabazuar në planin e rregullimit të qytetit, i cili ende nuk është miratuar nga KKT-ja. *Vendimi i gjykatës ka marrë formë të prerë dhe nuk është ankimuar në shkallë të dytë nga Bashkia Laç.*

Në dosje ka probleme me pronësinë e truallit, pasi vërtetimi i frekët nuk ka bashkëlidhur Hartën Treguese të Regjistrimit dhe zona ku është dhënë leja është në sipërfaqe të gjelbër.

D. KALLËZIM PENAL

Bazuar në ligjin nr. 7905, datë 21.03.1995 "Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, neni 281, me shkresën nr. 1077/8, datë 31.3.2014 kemi bërë kallëzim penal duke dërguar për veprime të mëtejshme procedurale në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Shkodër:

z. V.G. me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Urbanistikës.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Buxhetit të Pushtetit Vendor, Kontrollit të Territorit dhe Administrimit të Aseteve të Qëndrueshme.

Shënim: Auditimi është kryer nga audituesit **Josif Lile, Përparim Gjuzi dhe Din Zeneli** më tej u shqyrtua nga z. Niko Nako kryeauditues, z. Bajram Lamaj Drejtor i Departamentit, z. Ermal Yzeiraj, Drejtori i Drejtorisë Juridike, dhe Zbatimit të Standardeve, si dhe u verifikua si praktikë nga znj. Luljeta Nano, Sekretar i Përgjithshëm.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT